



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe radio "Alba", që të marrin pjesë në seancën e **II-të të rregullt të punës për vitin 2022.**

Seanca mbahet **më 25.02.2022 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00.** Mbledhja do të mbahet duke respektuar masat e marra sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës për mbrojtje nga pandemia.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seances se kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2021 (ref nga ekz),
5. Shqyrtimi i raportit financiar Janar-Dhjetor 2021 (ref. drejt. FEZH),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për rritje të buxhetit për vitin 2021 dhe bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 (ref drejt. FEZH),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr. 01nr.06-7775/2021 i datës 04.03.2021 për shpallje "Zonë me interes Publik" parcelën nr. P-71010080-00109-2 ZK Çabiq (ref. drejt. DSHPE),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje "Zonë me interes publik" parcelën me nr. P-71010080-00109-4 ZK- Çabiq (ref. drejt.DSHPE)
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarje të parcelës për ndërtim të objektit për zjarrfikës (ref. drejt. DUMM),
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionareve në kompaninë K.R.M. "Ambienti" njësia Pejë,
11. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për formimin e këshillit organizativ të festivalit "I këndojmë lirisë",
12. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit të komunës me qytetar për vitin 2021,
13. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKSB-së për vitin 2022,
14. Propozim-vendimi për themelim të pesë (5) komiteteve tjera të Kuvendit.
15. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-5116 2022
Klinë, me 18.02 2022



Kryesuesi,
Fadil Gashi